



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT**

V E N D I M

Nr. 04, datë 25.06.2025

PËR

**MIRATIMIN E NDYSHIMIT TË PROJEKTIT GJATË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“RIKONSTRUKSIONI I GODINAVE TË MATERNITETIT “MBRETËRESHA
GERALDINË” DHE NDËRTIMI I RI 3 KAT”, ME VENDNDODHJE
NË BASHKINË TIRANË**

Në mbështetje të 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të zhvilluesit Spitalit Universitar Obsetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit për objektin: “Rikonstruksioni i godinave të maternitetit “Mbretëresha Geraldinë” dhe ndërtimi i ri 3 kat”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me zhvillues Spitalin Universitar Obsetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave miratuar me Vendimin Nr. 14, datë 28.09.2022 të Këshillit Kombëtar të Territorit, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij Vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

ALBANA KOÇIU



A circular official stamp of the Ministry of Health and Social Protection of the Republic of Albania, Tirana. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISË", "MINISTRI I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE", and "TIRANË". A handwritten signature in blue ink is written over the stamp.

ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



A circular official stamp of the Agency for Territorial Development of the Ministry of Health and Social Protection of the Republic of Albania. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISË", "AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT", and "MINISTRI I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE". A handwritten signature in blue ink is written over the stamp.

Nënshkruar më datë 25/09/2025